

PLANI I INTEGRITETIT 2024-2026

AKZM |

AGJENCIA KOMBËTARE E
ZONAVE TË MBROJTURA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**

DEKLARATË INSTITUCIONALE

Plani i Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që cenojnë integritetin. Forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion janë të rëndësishme në kuadër të reformave të administratës publike, prioritet ky i cili zë një vend kryesor në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

Plani Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura 2024-2026, përfshin një analizë të vlerësimit të risqeve të integritetit në institucion, si dhe parashikon masa konkrete për zbatim, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, ritjen e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është kryer në fushat e përgjegjësisë së institucionit, kryesisht në: a) fushën e menaxhimit financiar; b) transparencës; c) burimeve njerëzore; d) konsultimit publik; dh) informimit; e) fushën e etikës, si dhe fusha të tjera të veprimtarisë së institucionit.

Plani i Integritetit ka një rol të rëndësishëm për institucionin, dhe konkretisht në:

- Forcimin e transparencës në institucion, për të siguruar ritjen e besueshmërisë publike;
- Burime njerëzore të kualifikuara, të qëndrueshme, dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
- Përmirësimi kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion.

Nevoja për të vendosur sisteme efektive të menaxhimit të integritetit, është shumë e rëndësishme, me qëllim që të garantohet kryerja e veprimtarisë me etikë, integritet, dhe performacë të lartë. Në këtë mënyrë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është e angazhuar plotësisht për të vijuar me përmirësimin dhe forcimin e integritetit në institucion.

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. HYRJE**
- II. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**
- III. OBJEKTIVAT**
- IV. PROCESI HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**
- V. QASJA METODOLOGJIKE**
- VI. ANALIZA E OBJEKTIVAVE**
- VII. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT**
- VIII. RISQE TË PËRGJITHSHME**
- IX. PLANI I VEPRIMIT**
- X. MONITORIMI**
- XI. ANEKS**

I. HYRJE

Plani i Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili synon përmirësimin e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies dhe rritjen e besueshmërisë publike, duke përcaktuar masa konkrete për zbatim, trajtimin e risqeve të integritetit si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Plani i Integritetit u hartua gjatë katërmujorit të tretë të vitit 2023 dhe i sjell efektet e tij për vitet 2024-2026, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Misioni i hartimit të këtij plani është përfshirja e analizës sistematike të riskut, sipas fushës së përgjegjësisë së institucionit, si dhe përcaktimi i masave të përshtatshme për përmirësimin e performancës, llogaridhënies dhe transparencës së institucionit.

Në këtë kuadër, procesi i menaxhimit të riskut të integritetit është një proces nëpërmjet të cilit institucioni adreson në mënyrë metodike risqet e integritetit për proceset e punës, e aktivitetet, sipas fushës së veprimtarisë së institucionit.

Ky Plan Integriteti është hartuar në përmbushje të objektivit strategjik A.9 "Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë" dhe A.9.4 "Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive" të Planit të Veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit miratuar me VKM Nr.247, datë 20.03.2015, të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit për evidentimin e hapësirave për korrupsion dhe forcimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

II. QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit ka një rol shumë të rëndësishëm për institucionin dhe konkretisht në forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës, forcimin e rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit, si dhe përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion.

III. OBJEKTIVAT

Nëpërmjet Planit të Integritetit synohet të arrihen këto objektiva:

1. Forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, duke siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
2. Burime njerëzore të kualifikuara, të qëndrueshme, dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
3. Përmirësimi i kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion;

IV. PROCESI HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

4.1 NGRITJA E GRUPIT TË PUNËS

Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin Nr.267, datë 19.07.2023, ka ngritur grupin e punës "Për hartimin e Planit të Integritetit 2024-2026", për realizimin e objektivit "A9 - Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë" të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015–2023, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.516, datë 01.07.2020.

Grupi i Punës u kryesua nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit Monitorimit dhe Regjistrimit të Zonave të mbrojtura dhe kishte në përbërje të tij anëtarë të nivelit drejtues dhe përgjegjës sektori të drejtorive të ndryshme të institucionit.

Hartimi i Planit të Integritetit është kryer nga Grupi i Punës, mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen qendrore, të miratuar me urdhrin nr. 334, datë 7.10.2020, të Ministrit të Drejtësisë. Gjatë këtij procesi, janë angazhuar dhe kanë kontribuar të gjitha strukturat e brendshme të Agjencisë, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

4.2 BAZA LIGJORE DHE MATERIALET REFERUESE

1. Ligji nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
2. Ligji nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
3. Ligji 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura";
4. Vendimi nr.516, datë 01.07.2020 i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247, datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve";
5. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 04.02.2015 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura", të ndryshuar;
6. Urdhri nr. 334, datë 7.10.2020 i Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore".

4.3 IDENTIFIKIMI I RISQEVË TË INTEGRITETIT

Gjatë kësaj faze, është kryer identifikimi i risqeve dhe faktorëve të tyre. Me qëllim identifikimin e risqeve dhe faktorëve të tyre, grupi i punës ka kryer një analizë të detajuar duke u koordinuar edhe me drejtoritë e tjera të institucionit. Kuadri i brendshëm rregullator, raportimet e ndryshme bazuar në veprimtarinë e drejtorive të institucionit janë të dhënat kryesore për këtë fazë. Mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, identifikimi i risqeve është realizuar kryesisht në fushën e: a) menaxhimit financiar; b) burimeve njerëzore; c) transparencës; d) konsultimit publik; dh) informimit; e) etikës, si dhe fusha të tjera të veprimtarisë së institucionit.

4.4 VLERËSIMI I RISQEVË TË INTEGRITETIT

Kjo fazë përfshin vlerësimin e risqeve të integritetit të identifikuara në fazën e mësipërme. Grupi i punës ka kryer vlerësimin e risqeve të identifikuara në lidhje me: a) mundësinë e ndodhjes së një risku; b) si dhe ndikimet që këto risqe mund të sjellin. Pas përcaktimit të mundësisë së ndodhjes së risqeve dhe ndikimeve të tyre, është vijuar me renditjen e risqeve, si dhe me propozimin e masave konkrete për trajtimin e tyre.

4.5 PLANI I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E RISKUT

Gjatë kësaj faze grupi i punës ka hartuar planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshin masa konkrete për përmirësimin dhe forcimin e integritetit në institucion. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

V. QASJA METODOLOGJIKE

Burimet që përdoren për vlerësimin e riskut të integritetit në institucion janë një kombinim i burimeve parësore si dhe burimeve dytësore. Burimet parësore përdoren për një analizë më të detajuar mbi risqet e integritetit, duke përfshirë një analizë të specializuar në lidhje me nivelin e risqeve (mundësisë së ndodhjes/shfaqjes së risqeve dhe impaktit në integritetin e institucionit). Burimet dytësore përdoren në fazën paraprake të procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, në mënyrë identifikimin e fushave më të ekspozuara ndaj riskut të integritetit.

Metodat e përdorura në vlerësimin e riskut të integritetit janë:

- a) Analiza e dokumenteve, metodë cilësore e cila përfshin një analizë të të gjitha akteve ligjore në fuqi në lidhje me: kuadrin ligjor për integritetin; kuadrin ligjor që rregullon fushën e veprimit të institucionit; të kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit, aktet administrative që përcaktojnë rregulla të përgjithshme dhe normative sjellje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin (për etikën, integritetin, konfliktin e interesave, parandalimin e korrupsionit); raporte të organizatave ndërkombëtare dhe organeve monitoruese, si dhe
- b) Analiza statistikore, e përdorur, bazuar në raporte të ndryshme, duke identifikuar dhe vlerësuar risqet si dhe faktorët e riskut.

VI. ANALIZA E OBJEKTIVAVE

I. FORCIMI I TRANSPARENCËS DHE MONITORIMI I VAZHDESHËM, DUKE SIGURUAR RITJEN E BESUESHMËRISË PUBLIKE

Forcimi i transparencës dhe monitorimi i vazhdueshëm, përbën një ndër objektivat kryesor që synohet të përmbushet.

Ky objektiv paraqet një rëndësi thelbësore, për arsye se nëpërmjet një procesi transparent, garantohet llogaridhënia dhe rritet besueshmëria publike mbi veprimtarinë e institucionit. Duke qenë se aktualisht ministria ka siguruar transparencë të plotë dhe të mirë për aktivitetin e saj operacional dhe organizativ, ky objektiv është parashikuar për zbatim edhe në këtë plan. Konkretisht është realizuar rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së institucionit, me anë të zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të konsultimit publik, të së drejtës së informimit, si dhe të tjera forma të bashkëveprimit aktiv institucional. Për më tepër është shënuar progres si në rritjen e numrit të akteve të konsultuara ashtu edhe në cilësinë e procesit, ku metodat e përzgjedhura për konsultim dhe targetimi i duhur i palëve të interesit ka ndikuar në hartimin e politikave dhe legjislacionit më cilësor, gjithëpërfshirës dhe efikas.

Për sa më sipër, nisur nga rëndësia e këtij objekti, synohet të vijohet me garantimin e një procesi transparent të veprimtarisë së institucionit. Në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të vazhdohet të publikohen të dhëna, informacione me karakter informues, por edhe informacione e dokumente që lidhen me mekanizmat monitorues, të kontrollit dhe llogaridhënës.

Faqja zyrtare e Agjencisë është e organizuar/ ndarë sipas seksioneve të veçanta ku Agjencia, publikon në seksionin e veçantë dokumentat, informacionet përkatëse, në mënyrë që çdo qytetar të ketë akses dhe të arrijë të informohet mbi aktet e publikuara. Linku i Agjencisë ku janë të publikuara këto akte si dhe vijnë të publikohen është si vijon; <https://akzm.gov.al/>.

II. BURIME NJERËZORE TË KUALIFIKUARA, TË QËNDRUESHME, DHE ME TRAJNIME TË PËRSHTATSHME PËR T'I REZISTUAR SHKELJEVE TË INTEGRITETIT

Forcimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion është shumë i rëndësishëm për një administratë publike efikase, transparente dhe të përgjegjshme në të gjitha nivelet.

Në këtë drejtim, synohet të vijohet me një proces transparent dhe të drejtë, për plotësimin e vendeve vakande, duke u mbështetur në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike.

Gjithashtu nëpërmjet këtij objekti synohet kryerja e vazhdueshme e trajnimeve me qëllim forcimin e integritetit të punonjësve, njohja në vijimësi me rregullat e etikës si dhe përmirësimi i njohurive të punonjësve, sipas fushës së veprimtarisë.

Trajtimet për stafin janë kryer në mënyrë të vazhdueshme, si dhe do të vijnë të kryhen pasi ndikojnë në forcimin e integritetit të punonjësve, por edhe rritjen e aftësisë profesionale, duke sjellë një performacë të lartë dhe sa më transparente në institucion.

III. PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR, ME QËLLIM FORCIMIN E INTEGRITETIT NË INSTITUCION

Ky objektiv thekson rëndësinë e respektimit të normave të etikës në Agjencisë, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator, me qëllim forcimin e integritetit në institucion. Përmirësimi dhe rishikimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullator ndikon në rritjen e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Agjencia ka kryer në mënyrë të vazhdueshme një rishikim të kuadrit rregullator për forcimin e integritetit në institucion. Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar rregullat e etikës, të cilat duhet të respektohen nga çdo punonjës i institucionit, si:

- kryerja e detyrave në zbatim me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të pavaruar nga pikëpamjet politike,

- kryerja e detyrave me paanësi, efikasitet,

- shmangia e konfliktit të interesit, si dhe rregulla lidhur me sjelljen korrekte që duhet të ndiqen në marrëdhënie me qytetarët, eprorët, kolegët dhe varësit.

Janë parashikuar dispozita lidhur me mospranimin e dhuratave, favoreve të ndryshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë, juridikë me të cilët nëpunësi/punonjësi ka marrëdhënie. Gjithashtu në rregullore janë përcaktuar edhe dispozita lidhur me funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të secilit punonjës.

Në rregullore është përcaktuar dhe këshillimi e informimi, ku njësia e burimeve njerëzore është përgjegjëse për këshillimin e çdo nëpunësi të Agjencisë për detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për standartet e sjelljes etike. Këshillimi për standartet e sjelljes etike ofrohet nga njësia e burimeve njerëzore: - Në momentin e fillimit të punës, - Gjatë ushtrimit të detyrës, përmes formimit profesional/ trajtimeve të planifikuara, si dhe rast pas rast.

Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura do të vijojë me rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator, me qëllimin forcimin e mëtejshëm të integritetit në institucion.

VII. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 4.2.2015, është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit dhe ka për detyrë administrimin dhe kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

AKZM ka statusin e Drejtorisë së Përgjithshme në nivel qendror, ndërsa në nivel vendor organizohet në bazë qarku, sipas administratave rajonale të zonave të mbrojtura. Funksionet, përbërja, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e Agjencisë, si organ qendror i specializuar për zonat e mbrojtura dhe institucioneve të varësisë së saj, parashikohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe miratohen me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Struktura dhe organigrama e AKZM-së dhe institucioneve të varësisë së saj miratohen me urdhër të Kryeministrit.

Pas kryerjes së procesit të vlerësimit të riskut në fushat e përgjegjësisë së institucionit, rezultoi se: Agjencia Kombëtare e Mjedisit u ristrukturua në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 188, datë 15.11.2022 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura" Sa më sipër, struktura e institucionit dhe vlerësimi i riskut sipas sektorëve është si më poshtë

Analiza në fushën e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit të Zonave të Mbrojtura

Drejtoria e Menaxhimit, Monitorimit dhe Regjistrimit të Zonave të Mbrojtura

Është struktura bazë teknike e AKZM-së dhe është përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e objektivave të zhvillimit të dy sektorëve në përbërje të drejtpërdrejtë të saj dhe të koordinojë punën me Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura. Dy sektorët përbërës të drejtorisë janë:

- Sektori i Menaxhimit
- Sektori i Monitorimit

Objektivat dhe detyrat kryesore të Sektorit të Menaxhimit:

- Përmirësimi i Menaxhimit të Resurseve Natyrore;
- Përgatitja dhe Zhvillimi i Planeve të Menaxhimit;
- Vlerësimi i kërkesave për zhvillim aktiviteti ekonomike apo veprimtari me karakter ekoturizmi brenda zonave të mbrojtura;
- Përditësim i Regjistrimit të Zonave të Mbrojtura;
- Promovimi i Turizmit të Qëndrueshëm;

Vlerësimi i faktorëve të riskut në Sektorin e Menaxhimit

Sektori i Menaxhimit në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura ka rol kyç në planifikimin, administrimin dhe mbrojtjen e resurseve natyrore, si dhe në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm brenda zonave të mbrojtura. Vlerësimi i faktorëve të riskut për çdo objektiv operacional shërben për të identifikuar cënueshmëritë, për të parandaluar devijimet nga standardet ligjore dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit publik.

Faktorët e Riskut të Identifikuar në Sektorin e Menaxhimit

Sektori i Menaxhimit ushtron funksione që lidhen me menaxhimin e resurseve natyrore, planifikimin, përgatitjen e dokumenteve strategjike, vlerësimin e kërkesave për aktivitete brenda zonave të mbrojtura dhe koordinimin me AdZM-të. Gjatë analizës janë

identifikuar faktorët e mëposhtëm të riskut që ndikojnë në integritet dhe efektivitet operacional:

1. Risqet në administrimin e të dhënave

- Të dhëna të paplota, të pasakta ose të papërditësuara.
- Pasaktësi në informacionet hartografike/GIS.
- Vonesa në përditësimin e regjistrave dhe dokumentacionit.

2. Risqet në proceset e planifikimit dhe hartimit të dokumenteve

- Mospërputhje me kërkesat ligjore dhe standardet teknike.
- Vonesa në përgatitjen dhe finalizimin e dokumenteve.
- Mungesë konsultimi efektiv me palët e interesuara.

3. Risqet në vlerësimin e kërkesave për aktivitete në zonat e mbrojtura

- Dokumentacion i paplotë ose i pasaktë nga aplikantët.
- Rrezik për interpretime subjektive të kriterëve.
- Verifikim i pamjaftueshëm në terren.

4. Risqet në monitorimin dhe kontrollin në terren

- Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe logjistike.
- Aktivitetet e paligjshme të vështira për t'u evidentuar në kohë.
- Koordinim i kufizuar me strukturat e tjera të kontrollit.

5. Risqet në komunikim dhe koordinim institucional

- Mospërputhje informacioni midis AKZM dhe AdZM-ve.
- Vonesa në qarkullimin e shkresave dhe informacionit teknik.
- Mungesë unifikimi të praktikave administrative.

Strategjitë Potenciale për Menaxhimin e Riskut- Sektorii Menaxhimit:

Për të reduktuar riskun në proceset e punës të Sektorit të Menaxhimit, nevojitet forcimi i administrimit të të dhënave përmes standardizimit të raportimeve, përditësimeve periodike dhe verifikimeve teknike para marrjes së vendimeve. Po ashtu, përmirësimi i procesit të planifikimit kërkon përcaktim të qartë të metodologjive, afateve dhe përgjegjësi, si dhe zhvillimin e konsultimeve transparente me palët e interesuara.

Në vlerësimin e kërkesave për aktivitete brenda zonave të mbrojtura, është i domosdoshëm aplikimi i procedurave të unifikuara, deklarimi i konfliktit të interesit dhe dokumentimi i plotë i çdo vendimarrjeje, i shoqëruar me verifikim paraprak në terren. Monitorimi i zonave duhet të mbështetet në bashkëpunim të ngushtë ndërinstitucional, planifikim të inspektimeve sipas riskut dhe përdorim të mjeteve teknologjike që rrisin saktësinë dhe efikasitetin.

Objektivat dhe detyrat kryesore të Sektorit të Monitorimit:

- Monitorime/Inspektime i aktiviteteve brenda territorit të ZM;
- Monitorimi i biodiversitetit në Zona të Mbrojtura;
- Parandalimin dhe organizimi për emergjencat civile;
- Hartimi i raporteve të vlerësimit të dëmit;
- Përditësimi i regjistrat të objekteve informale

Vlerësimi i faktorëve të riskut në Sektorin e Monitorimit

Sektorin e Monitorimit, për shkak të inspektimeve në terren dhe rolit kontrollues brenda zonave të mbrojtura, ekspozohet ndaj disa rreziqeve që lidhen me presione të jashtme, mungesë burimesh dhe devijime procedurale. Gjatë monitorimeve, inspektimeve, vlerësimit të dëmeve dhe përditësimit të të dhënave, ekziston rreziku i ndikimit nga subjekte që kryejnë aktivitete të paligjshme, si edhe i raportimeve të pasakta për shkak të ngarkesës së punës ose trysnive lokale. Po ashtu, mungesa e pajisjeve apo koordinimit në emergjencë civile mund të ndikojë në cilësinë e reagimit dhe në integritetin e procesit të raportimit.

Faktorët e riskut të identifikuar – Sektorin e Monitorimit

- Ndikime ose presione nga subjekte që zhvillojnë aktivitete të paligjshme në zonat e mbrojtura.
- Mangësi në burime njerëzore, logjistike ose pajisje për monitorim të plotë dhe efektiv.
- Raportime të pasakta, të vonuara ose të manipuluar.
- Mungesë koordinimi në situata emergjencash civile.
- Vështirësi në evidentimin dhe përditësimin e të dhënave për objektet informale.
- Rritje e ngarkesës së punës që çon në devijime procedurale ose gabime në terren.

Strategjitë Potenciale për Menaxhimin e Riskut – Sektorin e Monitorimit

Për të ulur riskun në proceset e Sektorit të Monitorimit, thelbësore është forcimi i planifikimit dhe dokumentimit të monitorimeve dhe inspektimeve brenda territoreve të Zonave të Mbrojtura, duke aplikuar metoda të standardizuara, përdorimin e pajisjeve të nevojshme dhe koordinim të vazhdueshëm me AdZM-të dhe institucionet mbështetëse. Rritja e kapaciteteve të stafit për identifikimin e shkeljeve dhe raportimin në kohë reale ndihmon në zvogëlimin e vonësive dhe pasaktësive që mund të ndikojnë në integritetin e procesit.

Në monitorimin e biodiversitetit, strategjitë përfshijnë harmonizimin e metodologjive të mbledhjes së të dhënave, kontrollin e cilësisë së informacionit dhe krijimin e protokolleve të rregullta për verifikim të terrenit. Kjo siguron që vendimarrja të bazohet në të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive mbështetëse (GPS, GIS, foto-dokumentim) ndihmon në shmangien e pasaktësive dhe rrit transparencën.

Në fushën e parandalimit dhe menaxhimit të emergjencave civile, nevojitet organizim i qartë i përgjegjësive, trajnime të shpeshta dhe koordinim me strukturat vendore të emergjencave, me qëllim që reagimi në situata kritike të jetë i shpejtë dhe i koordinuar. Plane të detajuara veprimi dhe stërvitje periodike minimizojnë riskun e keqmenaxhimit gjatë ngjarjeve emergjente.

Për hartimin e raporteve të dëmit, strategjitë fokusohen në standardizimin e formatit të vlerësimit, mbledhjen e provave të verifikueshme në terren dhe dokumentimin e qartë të procedurave për të shmangur subjektivitetin ose ndikimet e jashtme. Transparenca në hartimin e këtyre raporteve rrit integritetin dhe ul mundësinë e kontestimeve.

Për përditësimin e regjistrit të objekteve informale, thelbësore është mbajtja e një sistemi të rregullt përditësimi, verifikimi periodik në terren dhe krahasimi me të dhënat zyrtare, për të shmangur pasaktësitë që mund të ndikojnë në proceset e planifikimit dhe monitorimit. Zbatimi i një procedure të unifikuar për identifikimin dhe regjistrimin e objekteve informale ndihmon në krijimin e një baze të dhënash të besueshme.

Analiza në fushën e zhvillimit të projekteve

Drejtoria e Zhvillimit të Projekteve

Misioni i Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve është ndjekja, zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, me fokus zonat e mbrojtura, për ruajtjen promovimin e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe angazhimeve të Institucionit, që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE. Drejtoria e Zhvillimit të Projekteve përbëhet nga dy sektorë:

1. Sektori i Jetësimit të Projekteve;
2. Sektori i Ë.E.B-G.I.S dhe Komunikimit.

🌟 Objektivat dhe detyrat kryesore të Sektorit të Jetësimit të Projekteve:

1. Bashkëpunimi, koordinimi dhe menaxhimi efikas i projekteve;
2. Integrimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Biodiversitetit në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjes së biodiversitetit;
3. Përgatit raportet, kontributin e Institucionit lidhur me procesin e planifikimit dhe zbatimit të kërkesave të integrimit me fokus përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimin e tij;

Vlerësimi i riskut:

Sektori ekspozohet ndaj vonesave dhe devijimeve procedurale për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm, ngarkesës së punës, sfidave në integrimin e standardeve ndërkombëtare dhe pasaktësive në raportime.

Faktorët e riskut të identifikuar:

- Koordinim i pamjaftueshëm ndërinstitucional;
- Interpretim i pasaktë i standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit;
- Sfida në përafrimin me legjislacionin e BE-së;

Strategjitë e menaxhimit të riskut:

- Harmonizim i procesit dhe standardizim i dokumentacionit;
- Trajtime për menaxhimin e projekteve dhe përputhshmërinë ligjore;
- Verifikim dhe auditim i rregullt i raporteve dhe aktiviteteve;
- Koordinim i vazhdueshëm me institucionet dhe palët e interesuara;
- Përforsim i transparencës dhe dokumentimit të procesit.

🌟 Objektivat dhe detyrat kryesore të Sektorit të Ëeb GIS dhe Komunikim:

- Krijimi i programeve të specializuara të edukimit mjedisor për komunitetet vendore, shkollat dhe vizitorët. Përdorimi i mediave sociale dhe teknologjinë për të ndërgjegjësuar audiencat më të gjëra mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Përditësimi dhe përpunimi i hartave të territoreve të zonave të mbrojtura dhe zonimet e brendshme të tyre;
- Zhvillimi i faqes së internetit të përditësuar dhe të përshtatshme për të ofruar informacion të rëndësishëm për zonat e mbrojtura, harta interaktive, dhe burime multimediale për të rritur ndërgjegjësimin publik

Vlerësimi i riskut:

Sektori përballet me rreziqe që lidhen me cilësinë dhe përditësimin e të dhënave GIS, mbulimin e informacioneve për publikun dhe përdorimin efektiv të mjeteve digjitale.. Në fushën e komunikimit dhe mediave sociale, risku lidhet me mesazhe të paqarta, dobësi në transparencën dhe besueshmërinë e informacionit. Për zhvillimin e faqes së internetit dhe burimeve multimediale, sfida mbetet mbajtja e përditësimit të vazhdueshëm, siguria e informacionit dhe funksionaliteti i ndërveprueshëm për publikun.

Faktorët e riskut të identifikuar:

- Kapacitete të kufizuara teknike dhe njohuri digjitale të stafit;
- Rrezik nga mesazhe jo të qarta ose jo të harmonizuara për publikun;
- Sfida në përditësimin dhe funksionalitetin e faqes së internetit dhe burimeve multimediale.

Strategjitë e menaxhimit të riskut:

- Standardizim dhe kontroll i rregullt i të dhënave GIS dhe hartave;
- Përditësime periodike dhe auditim i informacionit digjital;
- Trajtime për staf mbi teknologjitë digjitale dhe komunikimin efektiv;
- Harmonizim i mesazheve edukative dhe përmbajtjeve në mediat sociale;
- Sigurimi i funksionalitetit të faqes së internetit dhe zhvillimi i burimeve multimediale të besueshme dhe të përditësuara.

Analiza në fushën e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Detyrat kryesore të kësaj drejtorie janë të sigurojë mirëadministrimin e aseteve e shërbimeve të Agjencisë, me qëllim sigurimin e kushteve për realizimin e misionit, të garantojë mirëmenaxhimin e burimeve financiare, për të siguruar mirëfunksionimin dhe arritjen e objektivave të Agjencisë, si dhe të realizojë menaxhimin, koordinimin, mbikëqyrjen e proceseve që lidhen me burimet njerëzore të institucionit.

Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë:

1. Sektori i Financës dhe Buxhetit;
2. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
3. Sektori i Asistencës Ligjore

Sektori i Financës dhe Buxhetit

Ka në strukturë 2 (dy) Specialist. Përgjegjësitë dhe objektivat e sektorit janë:

- Menaxhimi efikas dhe transparent i burimeve që financojnë veprimtarinë e AKZM-së, në zbatim të ligjit të buxhetit dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Hartimi i dokumenteve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);
- Asiston në përgatitjen e projekt buxhetit të AKZM-së;
- Krijon dhe mban dokumentacionin ekonomik e financiar të AKZM-së;

Vlerësimi i riskut:

Sektori përballet me rreziqe që lidhen kryesisht me menaxhimin e burimeve financiare, përgatitjen e dokumenteve buxhetore dhe mbajtjen e dokumentacionit ekonomik. Rreziqet më të rëndësishme lidhen me gabime ose vonesa në përgatitjen e dokumenteve, sfida në përputhshmërinë me legjislacionin financiar dhe nevojën për transparencë dhe kontroll të vazhdueshëm të përdorimit të fondeve.

Strategjitë e menaxhimit të riskut:

Për të ulur këto rreziqe, sektori fokuson standardizimin e procedurave financiare, verifikimin e rregullt dhe auditimin e brendshëm, trajtime periodike të stafit mbi legjislacionin dhe menaxhimin financiar, si dhe përmirësimin e transparencës dhe dokumentimit të vendimeve financiare. Këto masa sigurojnë përdorim efikas dhe të besueshëm të burimeve të AKZM-së.

Sektori i Asistencës Ligjore objektivat:

- Përgatitja, miratimi, dërgimi pranë strukturave përgjegjëse, ndjekja dhe realizimi i regjistrit të parashikimeve publike;

- Ndjekja dhe zbatimi i procedurave të prokurimit sipas legjislacionit në fuqi;
- Sigurimin e këshillimit dhe interpretimit ligjor për strukturat e tjera të institucionit për çështjet që shtrihen për shqyrtim;
- Përfaqësim i institucionit gjatë të gjitha proceseve gjyqësore administrative, civile në të gjitha shkallët e gjyqësorisë, duke ndjekur rregullisht çdo seancë gjyqësore;
- Përgatitja e rekomandimeve për ndryshimin dhe amendimin e legjislacionit ekzistues për zonat e mbrojtura Përgatitja e mendimeve juridike për të gjitha projektligjet dhe projekt-aktet e dërguara në adresë të Institucionit.

Vlerësimi i riskut:

Sektori i Asistencës Juridike përballët me rreziqe që lidhen kryesisht me përgatitjen dhe zbatimin e dokumenteve ligjore, interpretimin e ligjit dhe përfaqësimin e institucionit në procese gjyqësore. Rreziqet më të rëndësishme lidhen me mundësinë e gabimeve ose interpretimeve të pasakta ligjore, vonesave në procedurat e prokurimit ose dokumentacionin publik, si dhe nevojën për koordinim efektiv me strukturat e tjera të institucionit për të siguruar vendimmarrje të ligjshme dhe të besueshme.

Strategjitë e menaxhimit të riskut:

Për të minimizuar këto rreziqe, sektori fokuson standardizimin e procedurave ligjore, kontrollin dhe përditësimin e dokumentacionit, si dhe sigurimin e këshillimit të saktë dhe të shpejtë ligjor për të gjitha strukturat e institucionit. Trajnime periodike për staf, monitorim i rregullt i proceseve gjyqësore dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional mbështetësin transparençën dhe sigurojnë respektimin e ligjit në të gjitha aktivitetet.

🌟 Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka si detyrë funksionale procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen e stafit nëpërmjet një procesi transparent, identifikimin e nevojave për rritjen profesionale të stafit, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës në institucion, me qëllim krijimin e vlerave të qëndrueshme, drejtimin strategjik të politikave dhe planeve, si dhe efikasitetin në kryerjen e detyrave, që të mund, që të mund të realizohet misioni i Agjencisë.

Vlerësimi i riskut:

Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse përballët me rreziqe që lidhen me menaxhimin e stafit, rekrutimin dhe zhvillimin profesional, si dhe zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës. Rreziqet më të rëndësishme lidhen me proceset e mundshme jo të harmonizuara ose jo të qarta në përzgjedhjen dhe avancimin e stafit, mungesën e motivimit ose zhvillimit profesional të punonjësve, si dhe sfida në sigurimin e respektimit të etikës dhe transparencës në institucion.

Strategjitë e menaxhimit të riskut:

Për të ulur këto rreziqe, sektori fokusohet në krijimin e procedurave transparente për rekrutimin dhe avancimin e stafit, identifikimin e nevojave për trajnime dhe zhvillim profesional, si dhe zbatimin e vazhdueshëm të kodit të sjelljes dhe etikës. Monitorimi i rregullt i proceseve dhe trajnimet periodike për stafin ndihmojnë në sigurimin e një mjedisi pune të drejtë, efikas dhe të besueshëm, duke mbështetur realizimin e misionit të Agjencisë.

VIII. RISQET TË PËRGJITHSHME

Risqet lidhur informimin

Lidhur me të drejtën për informim, Agjencia përfaqësohet nga një nëpunës, që ushtron detyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Sipas legjislacionit në fuqi, Koordinatori për të Drejtën e Informimit ka për detyrë:

- a) t'i mundësojë çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik;
- b) të krijojë, mbajë, publikojë dhe përditësojë regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit ligjor;
- c) bashkërendojë punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve.

Për sa më sipër, një nga risqet kryesore që evidentohet në këtë fushë, lidhet me kërkesat e ardhura për informacion, ku kërkojnë të dhëna apo akte, për të cilat sipas legjislacionit në fuqi kufizohet e drejta e informimit. Në këto raste, lidhur me këto kërkesa, veprohet gjithmonë në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Një tjetër risk konsiston në faktin se për shkak të ngarkesave ndaj proceseve të punës, duhet të realizohet informimi brenda afateve ligjore. Megjithatë, nga ana e koordinatorit dhe drejtorive/ strukturave me të cilat bashkërendon punën bëhen përpjekje për të kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar.

Risqet lidhur me konfliktin e interesit

Nga ana e burimeve njerëzore lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit ndërmerren:

- Në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, sipas nenit 10 të këtij ligji, specifikohet se çdo zyrtar, nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin. Lidhur me sa më lart, konceptimi i autorizimit të konfliktit të interesit, për t'u nënshkruar nga Titullari dhe punonjësi/nëpunësi, hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, brenda 30 ditëve nga fillimi i marrëdhënieve financiare të nëpunësit.
- Deklarimi i konfliktit të interesit, kur ka dyshim të tillë në rastet e pjesëmarrjes si anëtar ose kryetar në komisione të ndryshme, duke nënshkruar deklaratë.
- Gjithashtu punonjësit pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës firmosin deklaratën në të cilën citohet se janë njohur dhe do të respektojnë detyrimet ligjore sipas nenit 16 dhe 17, të Kreut VI, të ligjit 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".

Në zbatim të legjislacionit në fuqi çdo nëpunës/punonjës shmang çdo situatë të konfliktit të interesit gjatë përmbushjes së detyrave, deklarohen interesat private pranë burimeve njerëzore të institucionit dhe respekton në çdo rast dispozitat e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Gjithashtu çdo nëpunës shmang angazhimin në aktivitete që përbëjnë ose mund të përbëjnë konflikt

interesi të çdo lloji, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

Risqet lidhur transparencën

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura kryen në mënyrë të vazhdueshme përditësime të faqes zyrtare të internetit, duke publikuar: aktet e miratuara, legjislacionin e zbatueshëm, programe e strategji të ndryshme në përputhje me fushën e veprimit, etj. me qëllim informimin në kohë të qytetarëve, si dhe rritjen e transparencës në kryejën e detyrave funksionale.

- Për sa më sipër, rekomandohet që të vijohet me publikimin e informacioneve dhe materialeve në faqen zyrtare të institucionit, me qëllim që çdo qytetar të ketë akses për t'u informuar. Gjithashtu rekomandohet që çdo material të publikohet në seksionin, rubrikën përkatëse të faqes zyrtare të ministrisë, në mënyrë që çdo qytetar t'a ketë më të thjeshtë për të gjetur informacionin që i nevojitet.

Risqet lidhur me etikën

Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar rregullat e etikës që duhet të zbatohen nga çdo punonjës i institucionit. Në mënyrë të përmbledhur disa nga rregullat janë si vijon:

- Kryerja e detyrave në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të pavarur
- Realizimi i detyrave me përgjegjësi, korrektësi, në respektim të procedurave administrative dhe afateve ligjore, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e performancës së administratës.
- Kryerja e detyrave me ndershmëri, paanësi, efikasitet, ruajtja dhe rritja e besimit të publikut
- Në çdo rast çdo nëpunës duhet të veprojë me integritet të lartë moral e profesional, në funksion të kryerjes së veprimtarisë administrative

Lidhur me cënimet që mund të shkaktohen nga punonjësit e institucionit ndaj normave të sjelljes, trajtohen në përputhje me rregulloren e brendshme, legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil apo Kodin e Punës për punonjësit me kontrata pune, si dhe Ligjin 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratës publike".

Risqet lidhur me korrupsionin

Lidhur me këtë risk në rregulloren e brendshme të Agjencisë është përcaktuar se çdo nëpunës nuk duhet të kërkojë, as pranojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për veten, familjen, e të afërmit, dhurata, favore, ose çdo përfitim tjetër të cilat jepen për shkak të pozicionit, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës. Në rregullore janë paraqitur në mënyrë të detajuar rastet lidhur me mospranimin të dhuratave, favoreve, apo çdo përfitimi tjetër. Për më tepër në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 927, datë 01.11.2021 "Për mënyren dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, në formë elektronike, në sistemin elektronik, për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave (EACIDS)", subjektet deklaruese janë të detyruar që të kryejnë deklaratimet përkatëse të pasurisë.

IX. PLANI I VEPRIMIT

Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së nëpunësit, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi, si dhe forcimin e integritetit në institucion, çdo nëpunës i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura duhet:

- Në çdo rast, çdo nëpunës i institucionit vepron me integritet të lartë moral e profesional, në funksion të kryerjes së veprimtarisë administrative;
- Nëpunësi duhet të jetë i paanshëm, i besueshëm, transparent, efektiv, duke realizuar me disiplinë dhe në kohë detyrat funksionale, në respektim të interesit publik
- Nëpunësi përdor në mënyrë efektive kohën e punës për realizimin me përgjegjësi dhe korrektësi të detyrave funksionale, duke kontribuar në rritjen e performancës së administratës, si dhe vepron në zbatim të legjislacionit, duke siguruar që procedurat administrative të zhvillohet brenda afateve ligjore.
- Sjellja e nëpunësit duhet të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat e parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë punonjësit e tjerë të veprojnë në përputhje me këto vlera.
- Nëpunësi shmang çdo situatë të konfliktit të interesit gjatë përmbushjes së detyrave, deklaron interesat private pranë autoritetit përgjegjës të institucionit dhe respekton dispozitat e legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
- Nëpunësi shmang angazhimin në aktivitete që përbëjnë ose mund të përbëjnë konflikt interesi të çdo lloji, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit.
- Komunikimi i nëpunësit duhet të karakterizohet nga etika, mirësjellja dhe respekti i ndërsjellë.
- Nxitja e zhvillimit profesional të nëpunësve në mënyrë të paanshme dhe gjithëpërfshirëse, përmes ofrimit të mundësive për kualifikim dhe ecuri të vazhdueshme në karrierë.
- Nëpunësi nuk duhet të kërkojë apo pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për veten, familjen, të afërmit, personat me të cilët ka marrëdhënie, dhurata, favore, ose çdo përfitim tjetër, të cilat jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës.

X. MONITORIMI

Monitorimi i Planit të Integritetit është një fazë e rëndësishme, për arsye se shërben për të vlerësuar nëse risqet e identifikuar janë menaxhuar në mënyrë të efektive, si dhe për të konstatuar nëse janë realizuar aktivitetet dhe masat e parashikuara në plan.

Monitorimi do të kryhet nga Koordinatori i Integritetit në bashkëpunim me drejtorinë e institucionit, të cilat duhet të raportojnë sipas fushës së përgjegjësisë brenda një periudhe 1-vjecare, mbi zbatimin e masave të parashikuara në Aneksin e Masave, aktivitetet e ndërmarra, si dhe objektivat e realizuara.

Nëpërmjet hartimi të raportit të monitorimit synohet:

- Forcimi llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike
- Përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit duke synuar sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore, procedurale, kuadrit të brendshëm rregullator, si dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.

Të gjitha aktivitetet që ndërmerren në kuadër të Planit të Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura do t'i njoftohen Titullarit dhe strukturave përgjegjëse në Agjenci. Raporti i Monitorimit do të publikohet edhe në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.